



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit me numër 24-560/2, të datës 07.05.2026 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës, me titull *"Ndikimi i reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor - impertativ i kohës"*, të kandidates Mr.sc.Havushe Rexhepi, komisioni në përbërje: Prof. dr.Lulzime Lutfiu Kadriu - kryetar, Prof. dr. Rabije Murati-anëtar, Prof. dr. Ardita Ceka - anëtar, Prof. dr. Besa Havziu- anëtar dhe Prof. dr. Maktfirete Ameti - anëtar, pasi e lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik i paraqet këtë:

R A P O R T
për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Punimi i disertacionit të doktoratës së kandidates **Havushe Rexhepi** i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoratës, si në aspekt strukturor po ashtu edhe në aspekt përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor.

Lënda e hulumtimit:

Problematika e reformave arsimore dhe e cilësisë së arsimit është një ndër temat më të studiuar në pedagogjinë bashkëkohore dhe në politikat arsimore ndërkombëtare. Literatura shkencore e trajton cilësinë e arsimit si një koncept shumëdimensional, i lidhur me efektivitetin e mësimdhënies, rezultatet e të nxënit, zhvillimin profesional të mësuesve, menaxhimin institucional dhe gjithëpërfshirjen. Studimi evidenton se përmirësimi i cilësisë lidhet ngushtë me zhvillimin profesional të mësuesve, modernizimin e programeve mësimore, përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, sistemin e vlerësimit dhe mbështetjen institucionale. Njëkohësisht, punimi identifikon edhe sfidat që vazhdojnë të ndikojnë në realizimin e plotë të objektivave reformuese, duke ofruar rekomandime të argumentuara për politikëbërësit dhe institucionet përgjegjëse. Objekti i hulumtimit është aktual dhe me rëndësi të veçantë, pasi trajton një problematikë që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e sistemit arsimor dhe me përmbushjen e standardeve bashkëkohore të arsimit.

Lënda i këtij hulumtimi është analiza e ndikimit të reformave arsimore në rritjen e cilësisë së arsimit fillor, me fokus të veçantë në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lënda e hulumtimit është e përcaktuar qartë dhe paraqet një problematikë me rëndësi të veçantë shkencore dhe shoqërore, pasi cilësia e arsimit fillor konsiderohet bazë e zhvillimit të kapitalit

njerëzor dhe e përparimit të përgjithshëm të shoqërisë. Lënda e këtij hulumtimi përqendrohet në analizën e ndikimit të reformave arsimore në rritjen e cilësisë së arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Studimi shqyrton procesin e reformimit të sistemit arsimor, ndryshimet e ndërmarra në organizimin e arsimit, kurrikulën, zhvillimin profesional të mësuesve dhe politikat arsimore, me synim të vlerësojë efektet e tyre në përmirësimin e cilësisë së procesit edukativo-arsimor. Në trajtimin e problematikës, autorja Mr.sc. Havushe Rexhepi demonstroi njohje të mirë të proceseve reformuese në arsimin fillor, duke i analizuar ato në kontekstin e zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe arsimore. Veçanërisht vlerësohet përpjekja për të lidhur aspektet teorike me realitetin e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjë që i jep punimit rëndësi shkencore dhe praktike.

Disertacioni me titull **"Ndikimi i reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor – imperativ i kohës"** trajton një nga çështjet më aktuale dhe më të rëndësishme të politikave arsimore bashkëkohore. Tema është zgjedhur në përputhje me zhvillimet dhe sfidat me të cilat përballen sistemi i arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kushtet e reformave të vazhdueshme dhe të orientimit drejt standardeve evropiane të cilësisë. Disertacioni mbështetet në literaturë bashkëkohore dhe në autorë vendorë e ndërkombëtarë, si dhe në dokumente strategjike të institucioneve kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e arsimit. Në këtë mënyrë, kandidati e vendos hulumtimin në kontekstin aktual shkencor dhe argumenton nevojën për vlerësimin empirik të efekteve të reformave arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Punimi plotëson një boshllëk në literaturën vendore, duke ofruar një analizë sistematike të ndikimit të reformave në cilësinë e arsimit fillor, çështje e cila deri më tani është trajtuar kryesisht në nivel teorik ose normativ.

Qëllimi i studimit

Arsimi është mjeti kryesor për funksionimin e një shoqërie të shëndoshë. Shoqëria jonë edhe pse më së shumti është fokusuar në risitë e shumta teknike-teknologjike, më atraktive dhe më shumë interesim shprehet në sfera të tjera të jetës, por prapëseprapë arsimi është mbi të gjitha. Për këtë arsye lënda e hulumtimit në këtë punim është arsimi dhe reformat që janë realizuar në të, efektiviteti i tyre, kushtet që i plotësojnë shkollat për realizimin e reformave etj. Për arsim të mirëfilltë reformat janë imperativ, domosdoshmëri sepse mundësojnë që të jetë në hap me arsimin e vendeve të zhvilluara, të jetë modern, atraktiv për nxënësit dhe motivues edhe për mësime dhënësit. Nëpërmjet këtij hulumtimi kandidatja vërteton se sa në shkollat tona reformat që janë realizuar deri tani kanë pasur efekt, sa kanë ndikuar në cilësi, apo thjesht kanë qenë vetëm dokumente të cilat duhet të implementohen dhe prej të cilave nuk ka pasur aspak lëvizje qoftë për përparësi ose mangësi. Hulumtimi synon të verifikojë nëse reformat kanë prodhuar ndryshime reale në cilësi apo janë perceptuar si dokumente që duhet të zbatohen pa ndikim të dukshëm në praktikë. Disertacioni në tërësi paraqet një analizë të gjerë dhe të rëndësishme mbi reformën arsimore dhe nevojën për modernizimin e dijes. Puna ka: bazë të mirë teorike; qasje kritike ndaj sistemit arsimor; strukturë tematike të qartë.

Në këtë kontekst, disertacioni me titull *"Ndikimi i reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor - impertativ i kohës"*, trajton problematikat teorike, metodologjike dhe empirike të kësaj çështjeje. Ai përbëhet nga **125 faqe të ndara në katërkapituj**, të cilët përfshijnë:

1. **Qasjen teorike mbi problemin e hulumtimit**
2. **Metodologjinë e përdorur në kërkim**
3. **Prezantimin, diskutimin dhe analizën e rezultateve të hulumtimit**
4. **Përfundimet, rekomandimet dhe bibliografinë**

Studimi përfshin gjithashtu **4 grafikone dhe 50 tabela**, duke ofruar dëshmi të qarta mbi ndikimin e reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se reformat arsimore kanë ushtruar ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor, megjithëse efektet e tyre ndryshojnë në varësi të nivelit të implementimit dhe të kushteve në të cilat ato janë zbatuar.

Në tërësi, rezultatet e paraqitura përbëjnë një kontribut të vlefshëm shkencor dhe praktik në fushën e pedagogjisë, duke ofruar evidencë empirike mbi efektet e reformave në arsimin fillor dhe duke krijuar bazë për hartimin e politikave të ardhshme të orientuara drejt rritjes së cilësisë së arsimit. Nga përmbajtja e disertacionit rezulton se kandidatja ka përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, duke integruar metodat kuantitative dhe kualitative të kërkimit shkencor. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes instrumenteve të standardizuara, si pyetësorët, analiza e dokumentacionit zyrtar dhe shqyrtimi i rezultateve të vlerësimeve arsimore. Për analizën e të dhënave janë përdorur metoda statistikore për testimin e hipotezave dhe interpretimin objektiv të rezultateve. Kjo qasje metodologjike mundëson një analizë më gjithëpërfshirëse të fenomenit të studiuar dhe rrit besueshmërinë shkencore të përfundimeve të nxjerra. Studimi ofron rekomandime të qarta, konkrete, praktike dhe të zbatueshme që përfshijnë dimensionet e rëndësishme: mësuesit, teknologjinë, menaxhimin dhe komunitetin, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me gjetjet e hulumtimit. Thëksohet rëndësia e evidencës empirike dhe monitorimit të vazhdueshëm. Struktura e këtij punimi është konceptuar në mënyrë të sistematizuar, duke përfshirë katër kapituj që zhvillojnë në mënyrë të hollësishme kornizën teorike, metodologjinë kërkimore, analizën e rezultateve dhe përfundimet përkatëse.

Pjesa hyrëse ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi fushën shkencore të studimit, duke argumentuar nevojën dhe rëndësinë e hulumtimit, si dhe duke artikuluar qartësisht problemin e trajtuar. Nga analiza e pjesës teorike konstatohet se kandidatja Mr.sc. Havushe Rexhepi ka ndërtuar një bazë të qëndrueshme konceptuale mbi nocionet e arsimit, edukimit, cilësisë në arsim, reformave arsimore dhe zhvillimit historik të sistemit arsimor. Punimi mbështetet në literaturë relevante pedagogjike, sociologjike dhe në dokumente strategjike kombëtare e ndërkombëtare, duke krijuar një kornizë teorike të përshtatshme për zhvillimin e hulumtimit.

Kapitulli i parë (fq. 8–71) fokusohet në qasjen teorik të studimit, duke përfshirë bazat konceptuale dhe arsyet mbi të cilat është ndërtuar kërkimi. Ky kapitull është më i gjerë në shtrirje dhe përfshin 14 tituj kryesor dhe 35 nëntituj. Në kapitullin e parë të disertacionit, kandidati ka ndërtuar bazën teorike mbi të cilën mbështetet i gjithë hulumtimi.

Qasja teorike e problemit të hulumtimit është titulli i parë që përmban në vete dy nëntituj kryesorë dhe është konceptuar në mënyrë logjike, duke filluar me arsyetimin e hulumtimit dhe argumentimin e problemit shkencor, për të vazhduar me analizën e reformave arsimore dhe rolit të tyre në përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor.

Në këtë pjesë evidentohet se autori e trajton arsimin si faktor strategjik të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, duke argumentuar se cilësia e sistemit arsimor është e lidhur ngushtë me procesin e reformimit të tij. Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke paraqitur evolucionin e tyre në periudha të ndryshme, dokumentet strategjike që kanë orientuar këto procese, si dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë ndikuar në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore. Korniza teorike është e ndërtuar në mënyrë të qëndrueshme dhe krijon bazën e nevojshme për formulimin e objektivave, hipotezave dhe analizës empirike të disertacionit.

Në tërësi, kjo pjesë karakterizohet nga një trajtim sistematik i problematikës, lidhje e mirë ndërmjet literaturës teorike dhe kontekstit arsimor të vendit, si dhe argumentim i qartë i rëndësisë shkencore dhe praktike të temës së hulumtimit.

Nga analiza e literaturës rezulton se çështja e reformave arsimore dhe e cilësisë së arsimit vazhdon të jetë një nga temat më të rëndësishme të kërkimit shkencor në pedagogjinë bashkëkohore. Gjendja aktuale e kërkimeve tregon se cilësia e arsimit nuk varet vetëm nga ndryshimet normative, por edhe nga niveli i zbatimit të reformave në praktikën pedagogjike. Në këtë aspekt, disertacioni pozicionohet si një studim që synon të ofrojë evidencë empirike mbi efektet reale të reformave në arsimin fillor, duke plotësuar një hapësirë të rëndësishme në literaturën shkencore vendore. Nga analiza teorike konstatohet se autori ka krijuar një bazë të qëndrueshme konceptuale për interpretimin e rezultateve empirike. Korniza teorike argumenton se reformat arsimore përfaqësojnë një mekanizëm të domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit, ndërsa efektiviteti i tyre kushtëzohet nga zbatimi sistematik, zhvillimi profesional i mësuesve, përmirësimi i kurrikulës dhe funksionimi efikas i institucioneve arsimore. Rezultatet e pritshme të hulumtimit synojnë të evidentojnë shkallën e ndikimit të reformave në cilësinë e arsimit fillor, të identifikojnë faktorët që favorizojnë ose pengojnë realizimin e tyre dhe të ofrojnë rekomandime të mbështetura në evidencë shkencore për avancimin e politikave arsimore.

Titulli i dytë është "Nocioni i arsimit dhe edukimit si veprimtari të rëndësishme shoqërore"

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së titullit të dytë të disertacionit, konstatohet se autorja ka trajtuar një nga çështjet themelore të bazës teorike të punimit, duke elaboruar nocionin e arsimit dhe edukimit, funksionet e tyre, si dhe rëndësinë që ato kanë në zhvillimin e individit dhe të shoqërisë. Kapitulli është organizuar në mënyrë logjike dhe përmban një renditje kronologjike të çështjeve teorike. Nga analiza e përmbajtjes vlerësohet se autorja ka konsultuar një numër burimesh bibliografike, duke përfshirë autorë klasikë të sociologjisë dhe pedagogjisë, si Robert Merton dhe Emil Durkheim, si dhe autorë vendorë që kanë kontribuar në fushën e pedagogjisë. Përfshirja e teorisë së funksioneve

manifeste dhe latente të arsimit, si dhe trajtimi i rolit të arsimit në proceset e socializimit dhe demokratizimit të shoqërisë, përbëjnë elemente pozitive të këtij kapitulli. Vlerësojmë se titulli i II-të përfaqëson një bazë teorike të pranueshme për disertacionin.

Titulli III – “Arsimi në të kaluarën”

Titulli i tretë trajton zhvillimin historik të arsimit, duke përfshirë evolucionin e tij nga shoqëritë e hershme deri në periudhat moderne, si dhe zhvillimin e shkollimit në trevat shqiptare. Autorja paraqet një pasqyrë të përgjithshme të ndryshimeve historike, duke e lidhur zhvillimin e arsimit me transformimet shoqërore, politike dhe ekonomike. Përfshirja e elementeve historike mbi zhvillimin e arsimit shqip në Maqedoni përbën një kontribut të rëndësishëm në kontekstin e punimit, pasi e lokalizon problemin e studimit në një realitet konkret shoqëror dhe historik. Po ashtu, trajtimi i arsimit si proces i lidhur ngushtë me ndryshimet shoqërore është në përputhje me qasjet sociologjike të arsimit.

Titulli i katërt shoqëria dhe arsini trajton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë dhe arsimit, duke analizuar ndikimin e faktorëve globalë dhe lokalë në sistemin arsimor, si dhe rolin e arsimit në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe politik. Në aspektin përmbajtësor, kapitulli trajton çështje me rëndësi të veçantë bashkëkohore, si krizat globale, transformimet shoqërore, roli i shtetit në arsim, si dhe funksioni i shkollës në shoqërinë moderne. Përfshirja e citimeve filozofike dhe sociologjike (p.sh. Aristoteli dhe Emil Durkheim) e pasuron dimensionin teorik të kapitullit. Po ashtu, vlerësohet përprerja për të lidhur arsimin me zhvillimin e shoqërisë, duke theksuar se investimi në arsim është faktor kyç për progresin ekonomik dhe social të shteteve moderne. Në përgjithësi, kapitujt III dhe IV përfaqësojnë një bazë të rëndësishme teorike dhe historike për disertacionin, duke trajtuar çështje relevante për zhvillimin e arsimit dhe raportin e tij me shoqërinë.

Titulli V – “Arsimi dhe pengesat tradicionale”

Kapitulli i pestë trajton pengesat tradicionale që ndikojnë në zhvillimin e arsimit bashkëkohor, si dhe përballjen ndërmjet shkollës tradicionale dhe asaj aktive. Autorja paraqet një analizë të gjerë mbi faktorët që ndikojnë në transformimin e arsimit dhe rolin e individit në procesin e arsimimit. Në aspektin përmbajtësor, kapitulli është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe trajton disa çështje thelbësore, si roli i individit në procesin e mësim, dallimi ndërmjet shkollës tradicionale dhe asaj aktive, si dhe kërkesat për një shkollë bashkëkohore. Përfshirja e këtyre elementeve tregon përprerje për të ndërlidhur teorinë pedagogjike me sfidat aktuale të sistemit arsimor. Vlerësohet pozitivisht trajtimi i konceptit të shkollës aktive dhe krahasimi i saj me modelin tradicional, duke evidentuar dallimet në qasjen ndaj nxënësit, metodave të mësimdhënies dhe rolit të mësimdhënësit. Po ashtu, theksohet rëndësia e trekëndëshit pedagogjik (nxënës-mësimdhënës-prind) si element kyç i shkollës bashkëkohore. Megjithatë, kapitulli ka karakter kryesisht përshkrues dhe në disa pjesë mungon thellimi analitik dhe kritik i koncepteve të paraqitura. Krahasimet ndërmjet shkollës tradicionale dhe

asaj aktive mbeten në nivel të përgjithshëm, pa u mbështetur në analiza empirike ose në studime bashkëkohore krahasuese.

Kapitulli i gjashtë **“Arsimi faktor që hap perspektivë”** trajton arsimin si faktor zhvillimor dhe perspektiv në shoqëri, duke e lidhur atë me emancipimin individual, zhvillimin shoqëror dhe kërkesat e tregut të punës. Autorja thekson rëndësinë e arsimit si instrument për progres shoqëror dhe personal. Në aspektin përmbajtësor, kapitulli përmban ide të rëndësishme mbi rolin e arsimit në zhvillimin e individit si qytetar aktiv, si dhe në ndërtimin e shoqërisë demokratike. Trajtimi i arsimit si proces futurologjik dhe i orientuar drejt së ardhmes është në përputhje me qasjet moderne të pedagogjisë. Po ashtu, vlerësohet përfshirja e diskutimeve mbi mendimin kritik, rolin e arsimit në demokraci dhe rëndësinë e reformave arsimore për përshtatje me sfidat bashkëkohore. Këto elemente i japin kapitullit një dimension aktual dhe relevant.

Kapitulli i shtatë **“Koncepti për arsim cilësor dhe si të sigurojmë atë”** trajton konceptin e arsimit cilësor dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsim, duke përfshirë vetevaluimin, inspektimin dhe evaluimin ekstern. Po ashtu, trajtohet koncepti i shkollës efektive dhe karakteristikat e saj. Në aspektin përmbajtësor, kapitulli paraqet një strukturë të mirë të organizuar dhe trajton çështje shumë të rëndësishme të menaxhimit arsimor modern. Përfshirja e niveleve të vlerësimit të cilësisë në arsim (vetevaluim, inspektim dhe evaluim ekstern) është një element i rëndësishëm që reflekton qasjet bashkëkohore të sigurimit të cilësisë.

Po ashtu, trajtimi i konceptit të shkollës së mirë dhe rolit të udhëheqjes shkollërore është relevant dhe në përputhje me literaturën bashkëkohore të menaxhimit arsimor. Theksimi i rëndësisë së udhëheqjes efektive dhe zhvillimit profesional të mësimeve është një nga pikat më të forta të kapitullit. Në përgjithësi, titulli i V, VI dhe VII përbëjnë një pjesë të rëndësishme të bazës teorike të disertacionit dhe trajtojnë tema relevante për zhvillimin e arsimit bashkëkohor.

Temat, reforma në arsim, reforma arsimore në qendër të nxënësit dhe nevoja për reformimin e dijes që përfshijnë titujt 8, 9 dhe 10 trajtojnë një temë me rëndësi të madhe shkencore dhe shoqërore: reformën në arsim dhe ndikimin e saj në cilësinë e procesit mësimor. Materiali është i gjerë, përmbajtësor dhe përfshin dimensione teorike, shoqërore dhe pedagogjike të arsimit bashkëkohor.

Autori trajton në mënyrë të qartë nevojën për reforma arsimore, duke e lidhur atë me zhvillimet teknologjike, ekonomike dhe shoqërore, si dhe me sfidat e sistemit arsimor në rajon.

- Kapitulli ka strukturë të qartë (arsyet, koncepti, pjesëmarrësit).
- Trajton reformën në mënyrë gjithëpërfshirëse (nxënës, prindër, mësues, institucione).
- Theksohet rëndësia e reformës si proces i vazhdueshëm dhe jo i izoluar.
- Përdor literaturë dhe referenca që rrisin besueshmërinë akademike.

Reforma arsimore në qendër të nxënësit : Vendos në qendër nxënësin si subjekt kryesor të reformës; Trajton çështje strategjike (kurrikula, decentralizimi, profesionalizmi); Përfshin dimension ndërkombëtar (PISA, krahasime rajonale); Ka qasje kritike ndaj politizimit të arsimit dhe problemeve strukturore.

Arsimi dhe nevoja për reformimin e dijes trajton një nga aspektet më të rëndësishme: cilësinë e dijes. Kritikon qartë mësimin mekanik dhe të mësuarit përmendësh, përfshin analiza mbi problemet reale të sistemit arsimor (PISA, infrastrukturë, politizim), dhe propozon orientim drejt të nxënit kreativ, kritik dhe problemor.

Titulli 11 – Kuptimi, qëllimi dhe parimet e reformës jep një bazë teorike të qartë mbi konceptin e reformës, Trajton qëllimin dhe parimet themelore në mënyrë të strukturuar dhe ndërlidh reformën me zhvillimin e sistemit arsimor.

Titullit 12–Sistemi arsimor dhe nevoja për reformim, thekson nevojën për reformim të sistemit arsimor. lidh sistemin arsimor me ndryshimet shoqërore dhe teknologjike, ka qasje kritike ndaj gjendjes ekzistuese.

Titulli 13 – Dokumente dhe koncepte strategjike në arsim, Titulli është shumë i pasur me informacion dokumentar dhe strategjik, paraqet zhvillimin historik të reformave arsimore në Maqedoni dhe përfshin strategji, programe dhe koncepte të ndryshme (1994–2025), si dhe jep pasqyrë të gjerë të politikave arsimore. Titull shumë i vlefshëm dokumentar.

Titulli 14 – Koncepti për arsimin fillor, trajton në mënyrë të detajuar komponentët e arsimit fillor, përfshin elemente të rëndësishme si: barazia, standardet, programet mësimore, cilësia, strukturë e qartë dhe logjike, fokus në gjithëpërfshirje dhe cilësi në arsim. Titull i strukturuar mirë dhe me përmbajtje të rëndësishme pedagogjike.

Titujt 11–14 ofrojnë një pasqyrë të gjerë dhe një analizë të zgjeruar të reformës arsimore në nivel teorik, strategjik dhe institucional duke u fokusuar në konceptin e reformës, sistemin arsimor, si dhe dokumentet dhe strategjitë kryesore që kanë udhëhequr zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Puna karakterizohet nga: **qasje e gjerë** dokumentare dhe teorike, strukturim i mirë tematik, fokus në politikat arsimore dhe strategjitë kombëtare

Kapitulli i dytë - Metodologjia e Hulumtimit (fq. 71-74)

Kapitulli i metodologjisë paraqet një strukturë të qartë dhe funksionale të dizajnit të hulumtimit. Ai përfshin të gjitha komponentët kryesorë të një studimi kuantitativ: lëndën e hulumtimit, qëllimet, detyrat, hipotezat, variablat, popullacionin, instrumentet dhe metodat statistikore. Përveç tyre ky kapitull përshkruan edhe pritshmëritë mbi rezultatet e studimit.

Tema është e rëndësishme dhe aktuale (reformat arsimore dhe efektiviteti i tyre). Qartësohet qëllimi i analizës së ndikimit të reformave në praktikë. Lidhje e mirë midis teorisë dhe realitetit shkollor. Objektivat dhe detyrat kryesore të këtij studimi janë të sinkronizuara me qëllimin e hulumtimit, që synon analizimin e reformave arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky studim ka për qëllim jo vetëm paraqitjen dhe përshkrimin e këtyre ndryshimeve, por edhe analizimin e ndikimit të tyre në cilësinë e arsimit fillor, duke u mbështetur në perspektivën e mësimdhënësve, nxënësve dhe drejtorëve në shkollat fillore.

Qasja e zgjedhur është kuantitative, e mbështetur në pyetësorë dhe analiza statistikore (përfshirë testin χ^2 dhe softuerin STATA), gjë që i jep studimit karakter empirik dhe të matshëm. Pasi është përcaktuar problematika e hulumtimit dhe janë konceptualizuar nocionet kryesore bazuar në literaturën shkencore dhe studimet relevante, përcaktohen objektivat dhe detyrat e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, variablat dhe operacionalizimi i tyre, instrumentet e përdorura, popullacioni dhe mostra, si dhe metodat statistikore për analizën e të dhënave, analiza të lidhjeve ndërmjet variablave përmes testit χ^2 . Për variablat me shkallë vlerësimi 1-5 janë llogaritur mesatarja, devijimi standard dhe intervali (min-max).

Meqenëse një pjesë e madhe e variablave në pyetësor janë të tipit kategorik (p.sh. " pajtohem plotësisht / deri diku / aspak"), për analizimin e lidhjeve ndërmjet variablave është përdorur testi hi-katror (χ^2). Ky test shërben për të vlerësuar nëse ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme ndërmjet dy variablave kategorike (p.sh. perceptimi për ndikimin e reformave dhe vendbanimi/gjinia). Interpretimi është bërë përmes vlerës p (p-value), ku vlerat $p < 0.05$ janë konsideruar si tregues i dallimeve/lidhjeve statistikisht domethënëse. Duhet theksuar se testi χ^2 nuk dëshmon shkakësi, por vetëm lidhje/varësi ndërmjet variablave, prandaj rezultatet janë interpretuar në kuadër të kontekstit pedagogjik dhe faktorëve shoqëruar të implementimit të reformave. Në rastet ku rezultati ishte domethënëse, lidhja është interpretuar si prirje e ndryshme e shpërndarjes së përgjigjeve ndërmjet grupeve, dhe jo si efekt shkakor.

Qëllimi dhe Detyrat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është që të fitohen njohuri relevante për rolin dhe rëndësinë që ka arsimi për njeriun, shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi, sa ai ka ndryshuar nga fillimi i themelimit të shtetit e deri tani, me Konceptin e fundit si dokument reformues, duke analizuar perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve mbi ndryshimet në procesin edukativ-arsimor, motivimin, rezultatet dhe zhvillimin profesional. Qëllimi është i qartë dhe i lidhur me temën. Detyrat janë të strukturuar

logjikisht (nga literatura deri te analiza e të dhënave).Përfshihen të gjitha fazat e hulumtimit, kurse struktura është në përputhje me hulumtimet kuantitative dhe kualitative. Disa variabla janë të përgjithshme (p.sh. "risitë"). Mostra është e qartë dhe e mirëpërcaktuar (drejtorë, mësime, nxënës), në hulumtim përfshihen disa qytete dhe shkolla, duke rritur përfaqësueshmërinë.Madhësia e mostrës është e përshtatshme për analizë kuantitative. Janë përdorur instrumente të përshtatshme (pyetësorë dhe intervista). Pyetjet në pyetësor janë të hapura dhe të mbyllura.Përdorimi i metodave të ndryshme (historike, deskriptive, krahasuese, statistikore) si dhe përdorimi i softuerit STATA është shumë pozitiv për nivel doktorature. Përfshirja e testit χ^2 është e përshtatshme për analizë lidhesh.

Hipotezat e hulumtimit

Janë të formuluar hipoteza kryesore dhe ndihmëse. Lidhen drejtpërdrejt me variablat e studimit.Janë të testueshme statistikisht dhe janë identifikuar qartë variablat e pavarura dhe të varura. Përfshihen indikatorë konkretë për matje. Hipotezat që janë ngritur në këtë punim dhe për të cilat do të japim përgjigje janë: një kryesore dhe disa ndihmëse:

H. Supozojmë se zbatimi i reformave në arsim në shtetin tonë do të ndikon në efektivitetin dhe ngritjen e cilësisë arsimore,

H1. Reformat janë të mirëpritura nga punonjësit arsimor.

H2. Në shtetin tonë ekzistojnë kushte për implementim të reformave në arsim.

H3. Ndryshimet në arsim ndikojnë në përmirësimin e statusit të nxënësit në mësim.

H4. Zbatimi i reformave ndikon në ngritjen profesionale të mësimeve.

H5. Implementimi i reformave në arsim në shtetin tonë është domosdoshmëri e kohës së sotme.

Variablat e hulumtimit- Në këtë studim janë identifikuar tre variabla të pavarura (kontrolluese): reformat, ndryshimet, risitë të cilët zbatohen në procesin edukativ-arsimor, ndërsa variablat e varura janë katër: cilësia e të mësuarit, përmirësimi i statusit të nxënësit, ngritja profesionale e mësimeve, suksesi i arritur i nxënësve. Në analizë, këto variabla janë operacionalizuar përmes indikatorëve konkretë të pyetësorëve (p.sh.ndikimi në punë, trajnimet, kushtet infrastrukturore, motivimi i nxënësve etj.) .

Popullata dhe Kampioni - Ky studim përfshin një kampion të përzgjedhur nga drejtorë (8), mësime (80) dhe nxënës (240) të shkollave fillore në disa qytete të R.M.V edhe atë: Shkup (Sh.F. "Liria"-Çair, Sh.F."Vasill Gllavinov") , Tetovë (Sh.F.K."Abdyl Frashëri"- Bogovinë, Sh.F."Migjeni"), Gostivar- (Sh.F.K." Mustafa Kemal Atatürk, Sh.F "Liria"-Vërtok) dhe Kërçovë (Sh.F."Milto Gura-Strellcë, Sh.F. "Naim Frashëri- Jagoll). Në çdo shkollë janë përfshirë nga 20 mësime, që dmth katër qytete nga 20 mësime-80, dhe poashtu nga 30 nxënës në çdo shkollë, që nënkupton 8 shkolla nga 30 nxënës, 240 nxënës gjithësej.

Mostra e hulumtimit përfshin mësime dhe nxënës të arsimit fillor nga zona të ndryshme. Analiza është realizuar mbi të dhënat e vlefshme të disponueshme në pyetësorë (me trajtim të mungesave si 'Pa përgjigje').

Kapitulli i tretë (fq. 74–114) paraqet analizën dhe interpretimin e rezultateve të hulumtimit. Fillimisht, jepet një përshkrim i karakteristikave socio-demografike të të anketuarve dhe shpërndarjes së variablave brenda kampionit. Më pas, realizohet interpretimi i hipotezave kërkimore, duke shqyrtuar dallimet në varësi të faktorëve të ndryshëm si: institucioni arsimor, niveli akademik, përvoja profesionale, vendbanimi, gjinia etj. Një vëmendje e veçantë i kushtohet analizës cilësore të intervistave të zhvilluara me drejtorët e shkollave fillore, të cilat ndihmojnë në interpretimin më të thelluar të reformave dhe ndikimit të tyre në rritjen e cilësisë në arsimin fillor si imperativ i kohës. Ky kapitull paraqet analizën dhe prezantimin e rezultateve të hulumtimit.

Kapitulli i katërt (fq. 114-124) përmblyll studimin me një diskutim kritik të rezultateve, përfundimet kryesore të nxjerra nga hulumtimi dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit fillor si rezultat i ndikimit të reformave në arsim. Punimi mbështetet në një bazë të gjerë teorike dhe empirike, me **58 referenca bibliografike**, të cilat përfshijnë citime dhe parafratime të burimeve relevante. Në fund, **shtojcat** përmbajnë instrumentet e përdorura në këtë studim, përfshirë **pyetësin e strukturuar prej disa pyetjeve të tipit të kombinuar për mësimdhënësit** pyetësor për nxënësit dhe **protokollet e intervistave me drejtorët (fq.106-113) e shkollave fillore të cilët janë të njoftuar paraprakisht**. Ky punim shtron një analizë të hollësishme të reformave në arsimin fillor të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke integruar qasje teorike dhe metodologji të avancuara kërkimore për të ndriçuar efektet e këtyre ndryshimeve në cilësinë e arsimit dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Në këtë kapitull, përfundimi paraqet një shqyrtim të gjetjeve të hulumtimit teorik dhe empirik, duke përfshirë hipotezat dhe rekomandimet. Kurrikulat në sistemet arsimore janë baza e cilësisë së arsimit. Për të arritur këto përfundime, janë analizuar të dhëna teorike dhe empirike, si dhe janë interpretuar hipotezat.

Seksioni i **Bibliografisë**, përmban burimet e literaturës, të cilat janë përdorur për shtjellimin teorik të këtij studimi. Në fund, **Shtojcat**, përmbledhin instrumentet e përdorura për hulumtimin sasior dhe cilësor.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Gjatë hartimit të këtij punimi të doktoratës me titull ***“Ndikimi i reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor - imperativ i kohës”***, kandidatja i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën e saj kërkimore-shkencore. Metodologjia e përdorur në këtë disertacion është e zhvilluar në disa faza dhe mbështetet në studime cilësore dhe sasiore, ndërsa për mbledhjen e të dhënave janë përdorur disa instrumente si: pyetësor për mësimdhënësit dhe nxënësit dhe intervistë e strukturuar.

Nga pjesa teorike rezulton se kandidatja ka konceptuar hulumtimin mbi një qasje metodologjike të kombinuar, duke integruar metoda kuantitative dhe cilësore. Studimi mbështetet në analizën e literaturës shkencore, dokumenteve strategjike dhe legjislacionit arsimor, ndërsa pjesa empirike parashihet të realizohet përmes instrumenteve të standardizuara të kërkimit dhe analizës statistikore të të dhënave. Përzgjedhja e metodologjisë është në funksion të arritjes së objektivave të hulumtimit dhe mundëson një vlerësim të argumentuar të ndikimit të reformave në cilësinë e arsimit fillor. Nga

pikëpamja metodologjike, ky studim mbështetet në një qasje të kombinuar kërkimore, duke integruar metoda të përgjithshme dhe specifike të hulumtimit për të analizuar ndikimin e reformave arsimore në rritjen e cilësisë të arsimit fillor.

Shikuar në aspektin metodologjik, teza e disertacionit përfshinë disa metoda hulumtuese që janë shfrytëzuar në këtë punim, të cilat janë: metoda historike- e cila shërben për të dhënë shpjegim se si është zhvilluar arsimi vite më përpara; metoda deskriptive- me anë të së cilës do të shërbehemi për të dhënë një përshkrim se si zhvillohet procesi edukativ-arsimor sot; metoda krahasuese- do të bëjmë komparacion se cila ka qenë mënyra më e përshtatshme për të realizuar mësimin dhe çfarë suksesi kanë treguar atëherë nxënësit dhe çfarë suksesi tregojnë tash;

Metodat e Përgjithshme të Hulumtimit- Metoda statistikore për përpunimin e të dhënave. Të dhënat e hulumtimit do të përpunohen me paketën profesionale për hulumtimin e të dhënave STATA.

Metodat Specifike të Hulumtimit - Metoda statistikore për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave duke përdorur teknika të përparura statistikore.

Metoda deskriptive – për të përshkruar gjetjet e studimit në aspektin e cilësisë së arsimit fillor, mbështetjes për implementimin e reformave dhe perceptimeve të mësimdhënësve.

Metodat Statistikore për Interpretimin e Hipotezave - Interpretimi i hipotezave bazohet në analiza statistikore deskriptive dhe inferenciale.

Hipoteza Gjenerale është interpretuar përmes analizës së të dhënave nga këto kategori kryesore:

Perceptimi i mësimdhënësve për reformat dhe Pranueshmëria dhe besueshmëria e reformave nga mësimdhënësit.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Rezultatet e këtij hulumtimi, të analizuara në përputhje me hipotezat e parashtruara, ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi nivelin e zbatimit të reformave dhe adresojnë pyetjet kërkimore të studimit. Përmbledhja dhe interpretimi i të dhënave mundësojnë konfirmimin ose hedhjen poshtë të hipotezave të formuluar. Në punim prezantohet qartë lidhja midis reformave dhe cilësisë së arsimit. Evidentohet ndikimi pozitiv i metodave interaktive dhe teknologjisë në mësim. Gjetjet statistikore janë të integruara në interpretim. Identifikohen faktorë parashikues të rëndësishëm të cilësisë arsimore. Kapitulli i analizës së rezultateve paraqet pjesën më të rëndësishme empirike të disertacionit, ku trajtohen të dhënat e mbledhura nga mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe analizat statistikore të avancuara. Struktura është e ndarë në mënyrë logjike në analiza deskriptive, krahasuese dhe inferenciale, duke përfshirë regresionin logjistik ordinal (ologit) dhe testin χ^2 . Kjo i jep studimit një nivel të lartë metodologjik dhe shkencor.

Vlerësim i analizës së mësimdhënësve - Analiza është e strukturuar qartë sipas variablave dhe hipotezave. Interpretimi lidhet drejtpërdrejt me rezultatet empirike. Paraqitja grafike rrit kuptueshmërinë e të dhënave. Përfshihet lidhja me faktorë si trajnimi, infrastruktura dhe burimet.

Vlerësim i analizës së nxënësve - Përfshin perceptimin e nxënësve si grup kyç në reformë. Analiza është e lidhur me indikatorë praktikë (teknologji, komunikim, aktivitete). Paraqitje grafike e qartë dhe ndihmuese. Vlerësim i analizës krahasuese dhe χ^2 (16.3). Përdorim i duhur i testit χ^2 për lidhje ndërmjet variablave. Rrit vlerën shkencore të studimit. Ndihmon në testimin e hipotezave në mënyrë statistikore.

Vlerësim i regresionit logjistik ordinal - Përdorimi i modelit ologit është shumë i përshtatshëm për të dhëna ordinal. Analiza është në nivel të avancuar statistikor. Përfshirja e variablës së vendbanimit rrit vlefshmërinë e modelit. Vlerësim i përmbledhjes së të dhënave të hapura. Përfshirja e pyetjeve të hapura shton dimension cilësor. Ofron perspektivë më të gjerë mbi perceptimet e pjesëmarrësve.

Vlerësim i shtojcave dhe tabelave:

Dokumentim i mirë i procedurave statistikore në STATA. Transparencë metodologjike (komanda dhe output). Organizim i qartë i tabelave sipas grupeve. Kapitulli i analizës së rezultateve përfaqëson pjesën më të avancuar dhe më të rëndësishme të disertacionit. Ai kombinon analiza deskriptive, krahasuese dhe inferenciale në mënyrë të strukturuar dhe metodologjikisht të saktë. Studimi demonstroi aftësi të mira në përdorimin e statistikës së avancuar dhe interpretimin e të dhënave empirike, duke rritur kredibilitetin shkencor të punimit. Megjithatë, për përmirësim të mëtejshëm rekomandohet: thellim më i madh interpretativ i rezultateve, raportim më i standardizuar i statistikave, dhe integrim më i fortë midis analizës cilësore dhe sasiore.

Përfundimi

Kontributet kryesore shkencore të kandidatës dhe fusha shkencore në të cilën do të aplikohen

Konsiderojmë së kandidatja në këtë punim të disertacionit të doktoratës ka përdorur terminologji të përshtatshme për nivel doktore ku struktura e tekstit është e qartë dhe e kuptueshme kurse gjuha është akademike dhe profesionale. Kandidatja Mr.sc. Havushe Rexhepi ka dhënë kontribut të duhur në analizën e detajuar në punimin e disertacionit dhe se ky punim shkencor do të kontribuojë në fushën e pedagogjisë, sepse hulumton në mënyrë të thelluar reformat në arsimin fillor, një aspekt i rëndësishëm për politikën arsimore dhe praktikën mësimore. Hulumtimi pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen shkollat, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore në vend, mungesat konkrete, duke ofruar kështu një bazë të dhënash për përmirësime të mëtejshme sistemore.

Punimi vë në dukje domosdoshmërinë që reformat në shkollat fillore duhet të jenë një temë e vazhdueshme në agjendën e takimeve. Thëks i veçantë vendoset edhe te pasiguria e mësimdhënësve lidhur me aftësitë e tyre për të përballuar këto ndryshime që jep mundësi për planifikim për rolin e mentorimit, veçanërisht për mësuesit e rinj.

Përfundimet janë të lidhura drejtpërdrejt me hipotezat e hulumtimit. Në punim theksohet ndikimi i reformave në cilësi, motivim dhe statusin e nxënësit. Prezantohet interpretim i të dhënave statistikore (korrelacion, regresion). Identifikohen faktorët kyç që ndikojnë në suksesin e reformave (trajnimi, infrastruktura, mbështetja institucionale). Pranohet qartë ekzistenca e sfidave dhe kufizimeve në implementim.

Kapitulli i përfundimit dhe rekomandimeve përbën një pjesë të rëndësishme dhe të realizuar mirë të disertacionit. Ai arrin të sintetizojë gjetjet kryesore të studimit dhe të ofrojë rekomandime të qarta për përmirësimin e sistemit arsimor. Studimi në tërësi dëshmon një qasje të strukturuar shkencore, me mbështetje empirike dhe orientim praktik, duke kontribuar në fushën e reformave arsimore në arsimin fillor. Ky kapitulli paraqet një sintezë të qartë dhe koherente të rezultateve të hulumtimit mbi ndikimin e reformave arsimore në arsimin fillor. Ai arrin të lidhë objektivat e studimit me gjetjet empirike dhe ofron interpretim të arsyetuar shkencërisht mbi efektet e reformave në cilësinë e arsimit. Teksti karakterizohet nga një strukturë logjike, gjuhë akademike dhe përputhje e mirë me metodologjinë e përdorur në studim.

Objektivat kryesore të këtij studimi janë në përputhje me qëllimin e tij, i cili ka të bëjë me ndikimin e reformave në arsimin fillor. Ky studim nuk synon vetëm përshkrimin dhe paraqitjen e këtyre ndryshimeve, por edhe analizimin e ndikimit të reformave në cilësinë e arsimit fillor nga këndvështrimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe drejtorëve të shkollave fillore.

Për të trajtuar në mënyrë të strukturuar problematikën e hulumtimit, studimi do të udhëhiqet nga detyrat e mëposhtme: Analiza dhe studimi i literaturës që ka të bëjë me arsimin fillor dhe reformat e zbatuara, të analizohet arsimi fillor dhe ndryshimet që janë implementuar në të etj.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Ky studim ka ofruar dëshmi të rëndësishme mbi ndikimin e reformave arsimore në rritjen e cilësisë në arsimin fillor, megjithatë rezultatet e tij hapin mundësi për hulumtime të mëtejshme që do të pasuronin njohuritë shkencore në këtë fushë. Në të ardhmen rekomandohet realizimi i studimeve longitudinale, të cilat do të mundësonin vlerësimin e efekteve afatgjata të reformave arsimore në arritjet akademike të nxënësve, zhvillimin profesional të mësuesve dhe funksionimin e institucioneve arsimore. Një qasje e tillë do të ndihmonte në identifikimin e ndikimeve që nuk mund të evidentohen përmes studimeve ndërsektoriale. Hulumtime të veçanta mund të fokusohen në ndikimin e trajnimeve profesionale të vazhdueshme të mësuesve dhe në identifikimin e modeleve më efektive të zhvillimit profesional, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënësve. Një drejtim tjetër i rëndësishëm është studimi i rolit të teknologjisë digjitale dhe inteligjencës artificiale në mbështetjen e reformave arsimore, duke analizuar ndikimin e tyre në motivimin e nxënësve, personalizimin e të nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave të shekullit XXI. Po ashtu, rekomandohet realizimi i hulumtimeve që do të përfshijnë perceptimet e nxënësve, prindërve, drejtuesve të shkollave në mënyrë që të sigurohet një vlerësim më gjithëpërfshirës i ndikimit të reformave në cilësinë e arsimit fillor.

Në të ardhmen mund të zhvillohen edhe studime që analizojnë ndikimin e faktorëve si infrastruktura shkollore, burimet mësimore, madhësia e klasave dhe mbështetja institucionale në suksesin e zbatimit të reformave arsimore. Këto hulumtime do të ndihmonin në identifikimin e faktorëve që lehtësojnë ose pengojnë realizimin e objektivave reformuese.

Në përfundim, hulumtimet e ardhshme duhet të orientohen drejt vlerësimit të vazhdueshëm të reformave arsimore përmes qasjeve shkencore të bazuara në evidencë, duke kontribuar në hartimin e politikave më efektive dhe në sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të cilësisë në arsimin fillor. Këto studime do të përbënin një bazë të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit arsimor dhe për harmonizimin e tij me standardet bashkëkohore ndërkombetare.

Vlerësim dhe propozim

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “**Ndikimi i reformave në rritjen e cilësisë në arsimin fillor - impertativ i kohës**”, të kandidates **Mr.sc. Havushe Rexhepi**, konstaton se punimi në fjalë i plotëson të gjitha kushtet të parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës dhe ka nderin që t’i propozojë Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof.dr. Lulzime Lutfiu Kadriu (kryetar) _____
2. Prof.dr. Rabiye Murati (anëtar) _____
3. Prof.dr. Ardita Ceka (anëtar) _____
4. Prof.dr. Besa Havziu Ismaili (anëtar) _____
5. Prof.dr. Makfirete Ameti (anëtar) _____

Tetovë, 07.07.2026